



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 611/1 Prot.

Tiranë, më 24.02.2023

VENDIM

Nr 7 datë 24.02 2023

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2023, PËR POZICIONET PJESË E SHËRBIMIT CIVIL, NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si dhe Vendimit të Kuvendit nr.10/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”,

V E N D O S A:

1. Miratimin e planit vjetor të pranimit, për vitin 2023, për pozicionet pjesë e shërbimit civil, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas grupeve të administrimit të përcaktuara në lidhjen nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Përcaktimi i pozicioneve specifike për çdo nivel, për vitin 2023, do të bëhet në përfundim të procesit të ristrukturimit.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani